



**VENDIM**

**Nr. 85, Datë 09.06.2016**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ERS-08” SH.P.K, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR .59, SERIA NPM08P, PER NDERTIM, INSTALIM, SHFRYTEZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERE NGA PARKU EOLIK KAVAJË, TE DHENE ME VENDIMIN NR. 63, DATE 13.06.2008**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike”; 5 dhe 6, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense”; 16 pika 2 dhe 18 te Rregullave te praktikës dhe procedurave te ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar; gërmat “d” dhe “e” të Vendimit nr. 63, datë 13.06.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve liçensës Nr. 59, Seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike, të dhënë me Vendimin nr. 63, datë 13.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE ne licencen e shoqërisë “ERS-08”sh.p.k,

**Konstatohet se:**

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “ERS – 08” sh.p.k në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
  - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 46, datë 28.05.2009
  - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 135, datë 15.11.2013,

- Me shkresën me Nr. 4 Prot., date 17.11.2014, shoqëria “ERS – 08” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 18 muaj të afateve të licensës së ndërtimit të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 63, date 13.06.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 135, date 15.11.2013.
- Mospërmbushja e pikës 1 gërma “d” të vendimit nr. 63 datë 13.06.2008, i ndryshuar e bën licencën të pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr.43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike", ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-8”sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licensës Nr. 59, Seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centrale Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë, të dhënë me Vendimin nr. 63, datë 13.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE.
2. Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k, Nr . 59, Seria NPM08P, të dhënë me Vendimin nr. 63, datë 13.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**